



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

CIMC 2009/01

RREGULLORE
PËR SUBJEKTET TRANSMETUESE PËR MBROJTJEN E
FËMIJËVE DHE TË MITURVE NGA PËRMBAJTJET E DËMSHME
PROGRAMORE

PREAMBULA

Bazuar në nenet 3.1, 3.2 dhe 3.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetim, si dhe në bazë të nenit 4 të Politikës së Transmetimit të Komisionit të Pavarur të Mediave (më tej “KPM”), për mbrojtjen e fëmijëve dhe konsumatorëve, si dhe në pajtim me parimet e lirisë së shprehjes dhe praktikat më të mira evropiane, Këshilli i KPM-së miraton këtë Rregullore për subjektet transmetuese për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme programore.

1. QËLLIMI:

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental, emocional dhe moral.

1.2 Kjo rregullore përcakton mënyrën e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve.

2. PËRKUFIZIMET:

2.1 Termi “*fëmijë*” i referohet personave, që i takojnë moshës nën 14 vjeç.

2.2 Termi “*i mitur*” i referohet personave, që i takojnë moshës prej 14 deri 18 vjeç.

- 2.3 Termi “kohë e kufizimit (Watershed)” është koha në orarin televiziv që ndan periudhën kur është e lejueshme për të shfaqur program televiziv që ka përmbajtje për të rritur prej periudhës kur nuk është e lejueshme. Koha e Watershed në Kosovë fillon prej orës 24:00 dhe mbaron në orën 05:00 mëngjesin tjetër. Në shërbimet e parapagimit të cilat nuk janë të mbrojtura me kod koha e kufizimit është po ashtu prej orës 24:00 deri në ora 05:00.
- 2.4 Termi “*dhunë*” i referohet përdorimit të qëllimshëm të forcës fizike, mekanike apo forcës tjetër, për të dëmtuar, lënduar apo keqtrajtuar.
- 2.5 Termi “*frikë*” i referohet një emocioni, shpesh të fuqishëm, që nxitet nga parashikimi për rrezik, të keqe, dhimbje, etj. pavarësisht se kërcënimi është real apo imagjinar.
- 2.6 Termi “*përmbajtje erotike*” u referohet materialeve programore, që përqendrohen tek dëshira seksuale, duke iu referuar qartësisht aktit seksual dhe që paraqesin zona të caktuara erogjene të trupit të njeriut dhe synimin final për akt seksual, por nuk i paraqesin personat në mënyrë të qartë gjatë marrëdhënieve seksuale.
- 2.7 Termi “*pornografi*” u referohet materialeve programore, të cilat në mënyrë të qartë dhe të hapur paraqesin organet ose aktin seksual të personave.
- 2.8 Termi “*programe me përmbajtje të dëmshme*” u referohet programeve, të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve.

Programet e pikës 2.8 përfshijnë, duke mos u kufizuar vetëm tek këto, përmbajtjet e mëposhtme specifike:

- a) Përmbajtjet me dhunë fizike, verbale, gjestikulative, emocionale, seksuale ose të përftuara nëpërmjet efekteve speciale. Dhuna e shfaqur në programe të veçanta artistike duhet të vendoset në kontekst, të ofrojë mesazhe edukative, mesazhe këto që duhet të jenë të kuptueshme lehtë si nga fëmijët, ashtu edhe nga publiku i gjerë. Kjo nënkupton që skenat me dhunë të mos jenë qëllim.
- b) Përmbajtjet me skena seksuale mund të pasqyrohen në kontekst ose në kuadër të programeve shkencore, edukative ose informative. Në këto përmbajtje duhet të shmangen skenat me shfaqje të tilla seksuale si ekzibicionizmi, nudizmi, dhuna seksuale, diskriminimi gjinor, etj. Përmbajtjet e tilla vlerësohen në bazë të qëllimit të çdo skene seksuale, duke e vlerësuar përshtatshmërinë e atij qëllimi në raport me moshën e shikuesve.

3. KUFIZIMET DHE OBLIGIMET E PËRGJITHSHME

3.1 Subjektet transmetuese nuk do të transmetojnë programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, përveçse në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë rregullore.

3.2 Subjektet transmetuese, të cilat transmetojnë radio programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik.

3.3 Subjektet transmetuese të cilat transmetojnë TV programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstual dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve në këtë rregullore.

3.4 Subjektet transmetuese mund të transmetojnë programe me përmbajtje pornografike vetëm në mënyrë të koduar dhe në pajtueshmëri me nenin 4.1.4 të kësaj Rregulloreje.

3.5 Në pajtim me këtë Rregullore, subjektet transmetuese duhet të përcaktojnë standarde vetërregulluese (Kodin Praktik) për transmetimin e programeve, që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët, si dhe të krijojnë mekanizma të mbikëqyrjes për aplikimin e këtyre standardeve.

3.6 Pas përpilimit të Kodit Praktik, secili subjekt transmetues do t'i dërgojë një kopje KPM-së jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Subjektet transmetuese mund ta paraqesin Kodin Praktik në mënyrë individuale apo grupe.

3.7 Me kërkesë të KPM-së, brenda 3 ditëve të punës, subjektet transmetuese duhet të paraqesin të dhëna të detajuara mbi implementimin e standardeve vetërregulluese të Kodit Praktik.

4. GJUHA

4.1 Gjuha vulgare dhe ofenduese nuk duhet të përdoret në programet e prodhuara dhe të emituara për fëmijë.

5. RESPEKTIMI I DINJITETIT TË FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË PROGRAME

5.1 Duhet t'i kushtohet kujdes i duhur dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve të cilët janë pjesë ose janë të përfshirë në programe. Kjo rregull duhet të zbatohet pavarësisht nga çdo pajtim që jepet nga prindi, kujdestari ose ndonjë person tjetër mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeçare i cili e përfaqëson të miturin.

6. KATEGORIZIMI DHE KOHA E TRANSMETIMIT TË PROGRAMEVE

6.1 Kategorizimi i programeve

6.1.1 **Kategoria e parë** përfshin programet që nuk kanë përmbajtje të dëmshme.

6.1.2 **Kategoria e dytë** përfshin programet që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 10 vjeçare dhe për të cilat është e domosdoshme prania e prindit ose kujdestarit. Kjo kategori u referohet programeve, që përmbajnë ndonjë skenë dhune ose frike. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjë përkatëse.

6.1.3 **Kategoria e tretë** përfshin programet, që përmbajnë skena dhune dhe frike, si dhe përmbajtje erotike, të cilat përsëriten relativisht shpesh. Këto përmbajtje të dëmshme programore nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 14 vjeçare. Për programet e kategorisë së tretë prania e prindit, kujdestarit, është e domosdoshme. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjë përkatëse.

6.1.4 **Kategoria e katërt** përfshin programet, që përmbajnë skena me përmbajtje të vazhdueshme dhune, frike si dhe me përmbajtje pornografike. Këto programe nuk rekomandohen për persona nën moshën 18 vjeçare. Transmetimi i programeve me përmbajtje të vazhdueshme dhune dhe frike duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjë përkatëse. Ndërsa, programet me përmbajtje pornografike mund të transmetohen vetëm në mënyrë të koduar.

6.2 Koha e transmetimit

6.2.1 Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së parë nuk i nënshtrohet kufizimeve kohore.

6.2.2 Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 17:00 deri në orën 06:00.

6.2.3 Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 23:00 deri në orën 06:00.

6.2.4 Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së katërt, mund të bëhet prej orës 24:00 deri në orën 05:00. Subjektet transmetuese mund të transmetojnë gjatë kësaj kohe programe me përmbajtje pornografike të cilat duhet të jenë të koduara.

7. SHENJAT DHE PIKTOGRAMET


- 7.1 Subjektet transmetuese do të përdorin piktogramet të paraqitura në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje.
- 7.2 Shenjat e vërejtjes për Kategoritë e përcaktuara me nenin 7 janë të detyrueshme për të gjitha programet e përcaktuara në nenin 6.
- 7.3 Para fillimit të programit dhe pas çdo ndërprerjeje në radio bëhet paralajmërim verbal dhe akustik.
- 7.4 Para fillimit të programit në TV shfaqet shenja e programit, e cila është kombinim i vërejtjes tekstuale, verbale, akustike dhe vizuale në kohëzgjatje prej 10 sekondave dhe mbulon të paktën $\frac{1}{4}$ e pjesë së dukshme të ekranit.
- 7.5 Gjatë programit televiziv shfaqet vetëm pjesa vizuale e shenjës në këndin e ekranit, me dimensione minimumi $\frac{1}{48}$ dhe maksimumi $\frac{1}{32}$.
- 7.6 Programet e Kategorisë së katërt nuk duhet të reklamohen para orës 23:00.
- 7.7 Skema programore e publikuar në teletext apo shtyp ditor duhet të reflektojë edhe shenjat vizuale për kategorinë përkatëse të programit.

8. SANKSIONET E APLIKUESHME

- 8.1 Për mosrespektim të kësaj rregulle do të aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media.

9. HYRJA NË FUQI

- 9.1 Rregullorja hyn në fuqi 15 ditën pas nënshkrimit nga Kryetarja e Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM).


Argjentina Grazhdani
Kryetare e Këshillit
Komisioni i Pavarur për Media



Prishtinë
Datë: 7/05/2009

CIMC 2009/01a

Shtojca

Kategoria	Klasifikimi	Shenja
Kategoria 1	Nuk do të përcillet me shenjë.	
Kategoria 2	Pëlqimi i prindit/kujdestarit i domosdoshëm ose i ndaluar për moshën deri 10 vjeç.	
Kategoria 3	Publik i rritur i ndaluar për moshën deri 14 vjeç.	
Kategoria 4	Publik i rritur, i ndaluar për moshën deri 18 vjeç.	